



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/56 /2011

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(c) dhe 17 pika 17.1 (n), nenin 40.2 (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03L-040 Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, nenit 38 të Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, udhëzimit Administrativ Nr.2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me shumicë dhe pakicë dhe për ndërmjetësim në tregti, nenit 6 dhe 32.5 të Statutit të Komunës, nenit 15.1 (a) të Rregullores për Punë të Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORËS PËR DHËNIEN E LEJES SË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

I

Aprovohet Rregullorja 01Nr.56/2011 në tekstin e mëtejme : Rregullorja për dhënie e Lejes së Punës për subjektet afariste në Komunën e Hanit të Elezit, e cila ka për qëllim ti përcaktoj kushtet për dhënie e lejes së punës për subjektet afariste .

II

Rregullorja për Leje Pune e përcaktuar si në pikën I të këtij Vendimi është hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, e përmbledhur në gjithsej 11 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesët: Drejtoria për Buxhet dhe Financa

IV

Rregullorja hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

V

Më këtë Vendim njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.06.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

